



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:035264

Datë: 02.07.2020

Numri i dokumentit: 01002581

**P.nr.1208/17**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Prizren** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 të KP, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II nr.3142-8/16 të dt. 29.05.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Musli Gashi të dëmtuarit Y.G dhe të akuzuarit, me datë 30.06.2020, publikisht mori dhe shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**A.B** nga i ati Z. dhe e ëma B., e lindur K., i lindur më .... në ... tani me banim në lagjen .... Komuna e Prizrenit rr. ... pa nr. punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar babë i .... fëmijëve, identifikohet me letër njoftim me nr. ...., me nr. tel. ..., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Se në muajin shtator të vitit 2016, në Prizren, i pandehuri blen telefonin e vjedhur të markës "...." me ..., nga një person i panjohur, ku e kishte ndërruar me një telefon të vetin dhe i kishte dhënë diferencë shumë prej 25€, edhe pse i pandehuri ka mundur ta dijë se telefoni është përfituar me kryerjen e veprës penale, e që ky telefon i ishte vjedhur të dëmtuarit Y.G nga vetura e tij, me datën 16.09.2016.

Andaj gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 7, 8, 9, 10, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe të veprës penale blerja pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje **prej 3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale .

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 Euro dhe për kompensim të viktimave në shumë prej 30€, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Prizren, ka parashtruar Aktakuzë, PP/Inr.3142-8/16 të dt. 29.05.2017 kundër të akuzuarit A.B nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara nga vepra penale nga neni 345 par. 2 të KP. Aktakuzën e ka përfaqësuar prokurori shtetit Musli Gashi.

Gjykata në këtë çështje penale, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor pasi që i akuzuari ka parashtruar kundërshtim në aktgjykimin e gjykatës me të cilin është shqiptuar Urdhër ndëshkimor dhe i njëjti është dënuar me gjobë në shumë prej 200€.

Në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari pas leximit të aktakuzës dhe udhëzimit për pranimit të fajësisë e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjykata nuk ka vazhduar me procedurë të provave dhe i ka ftuar palët që të deklarohen në fjalën përfundimtare.

Prokurori shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se me pranimitin e fajësisë nga ana e të pandehurit është dëshmuar se gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës është konstatuar drejtë dhe se provat në të cilat është bazuar aktakuza janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme. Me vet pranimitin e fajësisë në këtë fazë të procedurës ka propozuar gjyqtarës që me rastin e caktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të pandehurit si dhe pendimitin e tij se nuk do të përsërisë më vepra penale të natyrës së njëjtë dhe as të natyrave tjera.

I dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar ; se ai ia lë gjykatës në vendosje, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim pasuror.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e pranon fajësinë , është e vërtet që ai ka blerë telefonin dhe nuk ka qenë i sigurt që nuk është i vjedhur . Ka gabuar, i vjen keq për këtë është i gjendjes së dobët ekonomike, babë i ... fëmijëve, i premtos gjykatës që në të ardhmen nuk do të bëj diçka të ngjashëm, kërkon që gjykata të ketë parasysh këto me rastin e shqiptimit të dënimit.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se në muajin shtator të vitit 2016, në Prizren, i pandehuri A.B, blen telefonin e vjedhur të markës “...” me ..., nga një person i panjohur , ku e kishte ndërruar me një telefon të vetin dhe i kishte dhënë diferencë shumë prej 25€, edhe pse i pandehuri ka mundur ta dijë se telefoni është përfituar me kryerjen e veprës penale, e që ky telefon i ishte vjedhur të dëmtuarit Y.G nga vetura e tij, me datën 16.09.2016

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit e i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajësinë. Andaj si konsekuencë e pranimit të fajësisë nga i akuzuari, gjykata fare nuk është lëshuar në administrimin e provave.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e në harmoni me nenin 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme dhe e marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit të lartë-theksuar.

Gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën-pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë. Pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzime, i mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë parashtruar në aktakuzë, e ku për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar (me provat materiale). Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 e 248 të KPP-së dhe faktet që përmban propozim akuza. Andaj bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe faktet-provat që janë parashtruara me aktakuzë, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara nga vepra penale nga neni 345 par. 2 të KP, për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPK-së, të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, i vjen keq që kjo ka ndodhur, i premtion gjykatës se nuk do të ndodh diçka e ngjashme.

Andaj, bazuar në rrethanat e lartë-theksuara gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënimin me kusht, respektivisht dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohorë prej 1 (një) viti nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të tij

dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen i akuzuari të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi mos udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil është bazuar në nenin 461 par. 1 të KPP pasi që i dëmtuari nuk është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale (paushallin gjyqësor) gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e kompensimit për Fondin e Kompensimit të viktimave është marr në kuptim të nenit 6 dhe 39 par.3 pik.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensim të Viktimave të Krimet .

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
P.nr.1208/17 e dt. 30.06.2020**

**2018:035264, 02.07.2020**

**G j y q t a r i**

---

**Shpresa Emra**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.